



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog  
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

**Agjencia Kadastrale e Kosovës/Katastarska Agencija Kosova/Kosovo Kadastral  
Agency**

Në bazë të neneve 4.7, 29 dhe 34.2 të Ligjit për Kadastrin nr. 04/L-013 i shpallur ne Gazetën Zyrtare nr. 13 me 01.09.2011 , nenit 1.1 , 3.7 të Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme nr. 2002/5, 2003/13 , Nr. 04/L-009 i shpallur ne Gazetën .Zyrtare nr. 7 me dt. 10.08.2011 , Agjencia Kadastrale e Kosovës nxjerr:

**KORRNIZA PËR PUNË NR. AKK 2013/01  
PËR KORRIGJIMIN E SIPERFAQEVE**

**Neni 1.**

**Qëllimi**

1. Më këtë Kornizë pune behët zbatimi i Ligjit për Kadastrin dhe Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme për korrigjimin e sipërfaqeve .
2. Kjo Kornizë e punës rregullon procedurat , kushtet dhe procedurat e për korrigjimin e sipërfaqeve të parcelave kadastrale .

**Neni 2.**

**Korrigjimi i sipërfaqeve të parcelave kadastrale përmes Rindërtimit të informacioneve kadastrale**

1. Gjatë procesit të Rindërtimit të informacionit kadastral, korrigjimi i sipërfaqes të parcelës së regjistruar në RDPP bëhet pa ndonjë procedurë

të veçantë, në rastet se ndryshimi në mes të sipërfaqes nga matjet origjinale të terrenit (e cila do të regjistrohet) dhe sipërfaqes në RDPP është brenda tolerancës. Kjo paraprakisht krahasohet dhe vërtetohet mos ndryshimi me gjeometrinë e të dhënave grafike zyrtare (harta kadastrale dhe vektori).

2. Gjatë procesit të Rindërtimit të informacionit kadastral nëse kemi të bëjmë me matjet origjinale që e japin sipërfaqen e parcelës jashtë tolerancës nga ajo ligjore, atëherë nga Operatori Ekonomik do të zhvillohet seancë dëgjimore. Në seancë dëgjimore duhet të marrin pjesë pronari i parcelës, pronaret e parcelave fqinje dhe operatori ekonomik si dhe të nënshkruhet procesverbali nga akteret e lartpërmendur. Ndërsa komisioni i rindërtimit e shqyrton dhe merr vendim meritore.

### Neni 3

#### Korrigjimi i sipërfaqeve me mirëmbajtje të rregullt

1. Me mirëmbajtje të rregullt sipërfaqja Ligjore në RDPP mund të korrigjohet nëse është në kuadër të tolerancës të përcaktuar me Kornizën 2005/02 për sipërfaqet vetëm pas aprovimit të pronarit dhe nënshkrimit të tij në studimin - elaboratin e përgatitur nga zyrtari i ZKK-s nga kompania gjeodete ose nga gjeodeti i licencuar. Nëse dallimi i sipërfaqeve është jashtë tolerancës, atëherë kjo behet në bazë të procesit të rirregullimit të kufijve.

### Neni 4.

#### Korrigjimi i sipërfaqeve dhe të dhënave të tjera në disa raste të veçanta

1. Në rastet kur pikat kufitare të një parcele nga matjet e terrenit nuk përputhen me kufirin e parcelës në pjesën grafike, por pronarët e parcelave të përfshira në këtë rast pajtohen me gjendjen faktike, atëherë bëhet zhvendosja e vektorit në pikat e matura.
2. Nëse vërtetohet se harta kadastrale ka zhvendosje paralele krahasuar me rrjetën gjeodezike të insertuar në atë hartë por sipërfaqet janë brenda tolerancës, atëherë duhet të kontrollohen edhe sipërfaqet e



parcelave fqinjë bazuar ne të dhënat grafike zyrtare (harta kadastrale dhe vektori). Çdo zhvendosje jashtë tolerancës duhet të diskutohet në një seancë dëgjimore me palët e përfshira në atë rast;

3. Për çdo kërkesë nga qytetarët për parcelim, bashkim, piketim etj ZKK-të, kompanitë gjeodete, gjeodetët e licencuar janë të obliguar që paraprakisht të bëjnë një studim të mirëfilltë të të dhënave që i kanë ne dispozicion si në vijim;

- 3.1. Të krahasohet baza tekstuale (RDPP) me të dhënat grafike(hartë, vektor);
- 3.2. Të analizohet harta kadastrale (a lidhet harta kadastrale përkatëse me hartat e tjera);
- 3.3. Të analizohet harta kadastrale duke insertuar pikat, poligonale, trigonometrike, pikat e rjetit referent të rendit të I-rë dhe të II-të apo edhe nga triangolacioni;
- 3.4. Të analizohet harta kadastrale me matjet origjinale të terrenit;
- 3.5. Pas perfundimit të të gjitha analizave të cekura me lartë dhe konstatimit se egziston kjo mos përputhje, atëherë ZKK-të duhet t'i drejtohen me shkrim AKK-së duke i bashkangjitur gjithë studimin që ZKK dhe akteret tjere relevantë kanë bërë paraprakisht në lidhje me këtë rast.

4. Për çdo kërkesë të qytetarit për parcelim, bashkim, piketim etj ZKK-të, kompanitë gjeodete, gjeodetët e licencuar janë të obliguar që se pari t'i bejne matjet origjinale të parces bazë nga e cila do të behet parcelimi, bashkimi, piketimi etj. Për shkak të ngritjes se standardit të azhurnimit dhe për shkak të saktësisë nuk lejohet nendarja e parcelës në bazën grafike (harta dhe vektori) e pastaj nga ato të dhena të behet vetem piketimi i pikave të reja në terren.

#### Neni 5 Dispozitat përfundimtare

Kjo kornizë pune hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës .

Prishtinë, me 01.02.2013

Kryeshefi Ekzekutiv i AKK  
Prof. Dr. Murat Meha

